

## NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës:

### **Specialist i Trajnimeve dhe Ecurisë Disiplinore të Nëpunësit** Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme

#### **Procedura: LËVIZJE PARALELE NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe VKM-së nr.243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), njofton se:

- **Znj. Evis Pano** do të vazhdojë konkurimin në procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive.

#### **Konkurimi:**

- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr. Reshit Çollaku, në datën **26.12.2023** ora **11:00**

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshëm i Ngritur në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë në 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnime dhe kualifikime në fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.
- b) **60 pikë** për intervistën e strukturuar me gojë.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Specialist i Trajnimeve dhe Ecurisë Disiplinore të Nëpunësit**.

Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, Kreu IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **26.12.2023**.

Njoftimi do të publikohet: në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **29.12.2023**.

*Njësia Përgjegjëse / Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)*